	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGIJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 1 nga 21</i>

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a  
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C  
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIËSTA KOSTT d.d



Nr. 695 Dt. 08.04.2022  
 PRISHTINË- A

## RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGIJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË


Bordi i Drejtorëve i KOSTT sh.a. në mbledhjen 131/22 të datës 28.03.2022 me vendimin vijues miratoi Rregulloren për Ndërtimet në Afërsi të Stabilimenteve Energjetike të Tensionit të Lartë:

### Vendim 220328-II/6

Bordi i Drejtorëve bazuar në nenin 162 paragrafi 1, nënparagrafin 1.12 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, nenin 31 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, nenin 14.2.6 të Statutit të Shoqërisë Aksionare KOSTT, Kërkesën Nr. 593 të datës 22.03.2022 dhe Analizën Ligjore Nr. 622 të datës 28.03.2022, me datë 28.03.2022, njëzëri miratoi Rregulloren për Ndërtimet në Afërsi të Stabilimenteve Energjetike të Tensionit të Lartë.


	Përgatiti/Rishikoi	Kontrolli profesional	Kontrolli i SIM	Propozoi për aprovim	Aprovoi
Emri dhe Mbiemri	Arian Maloku Sami Gashi Astrit Beqa Uran Xhafolli	Alban Imeri, Drejtor i DZHRRP Besim Gërxhaliu, Drejtor i DOT	Jusuf Imeri, Menaxher i Zyrës për Cilësi dhe Politika	Kadri Kadriu, u.d. Kryeshefi Ekzekutiv	Bordi i Drejtorëve Jeton Mehmeti - Kryesues i BD
Nënshkrimi					
Data	04.03.2022	Mars 2022	Mars 2022	Mars 2022	Mars 2022



	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 2 nga 21</i>

## PËRMBAJTJA

1. HYRJE .....	3
2. PËRKUFIZIMI I TERMAVE DHE SHKURTESAVE .....	4
3. QËLLIMI.....	5
4. FUSHËVEPRIMI.....	5
5. KUSHTET TEKNIKE .....	5
6. PROCEDURA E DHËNIES SË KUSHTEVE TEKNIKE.....	6
7. CENIMI I ZONAVE TË SIGURISË .....	6
8. INFORMIMI I PUBLIKUT .....	6
9. NDRYSHIMI I RREGULLORES .....	6
10. HYRJA NË FUQI .....	6
11. BURIMET DHE FORMULARËT .....	7
11.1. Burimet .....	7
11.2. Dokumentet dhe formularët.....	7
12. LISTA E SHPËRNDARJES DHE HISTORIKU.....	7
12.1. Lista e shpërndarjes .....	7
12.2. Shënime për versionet.....	8
13. SHTOJCAT .....	9
Shtojca A.....	10
Shtojca B .....	15
Shtojca C.....	17
Shtojca D.....	19

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 3 nga 21</i>

## 1. HYRJE

1. Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë sipas paragrafit 1 të nenit 27, stabilimentet energjetike që janë në posedim ose shfrytëzim të ndërmarrjes së energjisë, kjo ndërmarrje do të ketë të gjitha servitutet, të drejtën e shfrytëzimit dhe të drejtat tjera pronësore në ose ndaj pronës përkatëse.
2. Ndërsa sipas paragrafit 4 të po këtij neni, të gjitha linjat dhe tubat e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë që kalojnë përmes, mbi, në apo nën një pronë konsiderohet se e kanë të drejtën e servitutit të përhershëm mbi pronën e prekur në favor të ndërmarrjes së energjisë duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Servitutet e lartpërmendura u nënshtrohen standardeve dhe kufizimeve të detyrueshme të përcaktuara në aktet nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të këtij ligji.
3. Për më shumë, në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 31 të këtij ligji caktohet se stabilimentet energjetike përveç që kanë të drejtën e servitutit të përhershëm, caktohet se kanë edhe zona të sigurisë përreth tyre. Në këto zona është i ndaluar ose i kufizuar ndërtimi që mund të paraqet rrezik ndaj sigurisë ose veprimtarisë së pandërprerë të instalimeve energjetike, sigurisë së shëndetit, jetës ose pronës.
4. Ky ligj në paragrafin 3 të nenit 31 cakton se kushtet dhe mënyrat e përcaktimit të lokacionit, madhësinë, kufijtë e zonave të sigurisë, rregullimin e tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve përcaktohen me akt nënligjor nga ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë.
5. Ministria e Zhvillimit Ekonomik si ministri përgjegjëse për sektorin e energjisë përmes Udhëzimit Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë ka përcaktuar zonat e sigurisë përreth stabilimenteve energjetike, rregullimin e tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve me qëllim të operimit normal të stabilimenteve të energjisë dhe shmangies së rrezikut ndaj jetës apo shëndetit të qytetarëve, mjedisit dhe sigurinë e pronës në zonat e sigurisë.
6. Në paragrafin 6 të nenit 4 të këtij udhëzimi administrativ caktohet se çdo ndërtim, apo çdo punë e kryer nga pronari apo shfrytëzuesi i pronës që gjendet në zonën e sigurisë i nënshtrohet miratimit paraprak me shkrim, nga ndërmarrja e energjisë. Ndërtimi i tillë duhet t'i përmbushë kushtet adekuate teknike dhe të sigurisë dhe nuk duhet të vë në rrezik jetën, shëndetin, apo sigurinë e personave.
7. Rregullorja për Ndërtimet në Afërsi të Stabilimenteve Energjetike të Tensionit të Lartë përcakton zonat e sigurisë së stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë dhe kushtet adekuate teknike për ndërtimet në afërsi të tyre.
8. Rregullorja është hartuar nga Komisioni Profesional i emëruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it me Vendimin numër 2654 të datës 13.12.2021, në pajtim me ligjet, udhëzimet administrative dhe kodet teknike në fuqi.




	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 4 nga 21</i>

## 2. PËRKUFIZIMI I TERMAVE DHE SHKURTESAVE

1. Termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

Termi/shkurtesa	Përkufizimi
Distanca elektrike	Distanca minimale nga përçuesit e paizoluar të cilët operojnë në tension të lartë, brenda së cilës nuk lejohet të ndodhet asnjë pjesë e trupit ose cilitdo objekt.
DOT	Departamenti i Operatorit të Transmisionit
E drejtë e qasjes	E drejta e qasjes në pronë publike apo private për qëllime inspektimi, mirëmbajtje, riparimi, rregullimi, ndryshimi, zëvendësimi apo largimi të pajisjeve, dhe instalimeve të sistemeve të energjisë.
KOSTT	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a.
KSHE	Kryeshefi Ekzekutiv
Ndërtim	Ngritja, instalimi, zëvendësimi, renovimi, zgjerimi, ndryshimi, shndërrimi, apo rrënimin i çfarëdo ndërtese, ose objekti që apo rezulton nga punët ndërtimore.
Palë	Person fizik apo juridik që kërkon kushtet teknike për ndërtim në afërsi të stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë.
Profil i linjës transmetuese ajrore	Gjerësia e korridorit të projektuar nga njëri përçues i skajshëm i linjës transmetuese ajrore tek përçuesi tjetër i skajshëm i saj. Kjo gjerësi është e ndryshme në vartësi të tipit të shtyllave të përdorura për linjën ajrore.
Profil i linjës transmetuese nëntokësore	Gjerësia e kanalit në sipërfaqen e tokës në të cilin janë shtrirë kabllo e linjës transmetuese nëntokësore. Kjo gjerësi është e ndryshme në vartësi të nivelit të tensionit të lartë dhe mënyrës së shtrirjes së kabllove.
Pronar apo shfrytëzues i tokës	Pronari, apo shfrytëzuesi i tokës që gjendet brenda zonës së sigurisë.
Rregullorja	Kjo rregullore.
Servitut	E drejta e pronarit përkatës të një paluajtshmërie dominuese që një paluajtshmëri tjetër shërbyese në një mënyrë të caktuar ta shfrytëzojë apo të ndalojë kryerjen e veprimi të caktuar ose të përjashtoj ushtrimin e së drejtës së caktuar, të cila rrjedhin nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë shërbyese.
Stabiliment energjetike i tensionit të lartë	Pajisjet e ndryshme energjetike të tensionit të lartë që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike: linjat transmetuese (ajrore dhe nëntokësore) dhe nënstacionet.
Transmetim i energjisë elektrike	Transportimi i energjisë përmes sistemeve të tensionit të lartë dhe sistemeve të ndërlidhura të tensionit të lartë, me qëllim të dërgimit deri te konsumatorët fundorë, apo tek operatorët e sistemit të shpërndarjes, por pa e përfshirë furnizimin.
Tension i lartë	Tensioni i nivelit 110, 220 dhe 400 kV.
Zonë e sigurisë	Hapësirat e caktuara në të cilat janë të vendosura stabilimentet energjetike, me qëllim të mbrojtjes së sistemit të energjisë, jetën, shëndetin e qytetarëve apo të mirave materiale. Ato përfshijnë tokën, hapësirën ajrore apo ujën që i rrethon stabilimente energjetike të tensionit të lartë.

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 5 nga 21</i>

### 3. QËLLIMI

1. Qëllimi i Rregullores për Ndërtimet në Afërsi të Stabilimenteve Energjetike të Tensionit të Lartë është adresimi i kërkesave për ndërtim në afërsi të stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë që janë në pronësi të KOSTT-it.
2. Rregullorja po ashtu përmes përcaktimit të procedurës së dhënies së kushteve teknike për ndërtim në afërsi të stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë, synon të sigurojë qasje të barabartë, objektive dhe transparente ndaj të gjitha palëve.

### 4. FUSHËVEPRIMI

1. Rregullorja vlen për të gjitha stabilimentet energjetike të tensionit të lartë në pronësi të KOSTT-it.
2. Fushëveprimi i kësaj rregullore përfshin të drejtat dhe detyrimet e KOSTT dhe pronarëve, në pronat e të cilëve gjenden stabilimentet energjetike dhe objektet e ndërlidhura me qëllim të evitimit të ndërtimit të paligjshëm apo paraqitjes së pengesave tjera në zona të sigurisë brenda dhe rreth stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë.
3. Fushëveprimi i kësaj rregullore përfshin po ashtu procedurën e parashtrimit të kërkesave për kushte teknike për ndërtim në afërsi të stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë, si dhe miratimin ose refuzimin e kërkesat e tilla.

### 5. KUSHTET TEKNIKE

1. Brenda zonës së sigurisë së stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë është i ndaluar ndërtimi ose ngritja e çfarëdo ndërtese apo godine, apo edhe çfarëdo ndërtimi çoftë i përhershëm apo i përkohshëm (punëtori, stallë, rrethojë, pishinë, fushë sportive/rekreative), gjurmimi, mbushja, prishja, përmbytja, ujitja apo përmirësimi i tokës, kultivimi i bimësisë së lartë si drunjtë dhe pemët, prerja e drunjëve dhe e vegjetacionit, ose ushtrimi i aktiviteteve që mund të paraqesin rrezik ndaj sigurisë ose veprimtarisë së pandërprerë të instalimeve energjetike, sigurisë së shëndetit, jetës dhe pronës. Dimësonet e zonave të sigurisë për të gjitha stabilimentet energjetike të tensionit të lartë janë paraqitur në Shtojcën A.
2. Brenda zonës së sigurisë së stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë për raste të veçanta me interes publik lejohej ndërtimi i rrugëve, linjave ajrore që operojnë në tensione më të ulëta, linjave telekomunikuese dhe infrastruktuës nëntokësore nëse plotësohen kushtet teknike dhe distancat minimale të Kodit të Pajisjeve Elektrike të paraqitura në Shtojcën B.
3. Gjatë ndërtimeve në afërsi të zonave të sigurisë së stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë duhet të plotësohen distancat minimale të sigurisë sipas ligjeve në fuqi të paraqitura në Shtojcën C.
4. Me qëllim të mirëmbajtjes së stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë KOSTT ka të drejtë qasje në tokat brenda dhe rreth zonës së sigurisë. Në rastet kur punonjësit e KOSTT-it me makineritë e tyre gjatë inspektimeve, kontrollimeve apo edhe mirëmbajtjes së stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë shkaktojnë dëmtime, pronari apo shfrytëzuesi i tokës do të kompensohet sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë.
5. Çfarëdo dëme që mund të shkaktohen gjatë ndërtimit qofshin ato në prona private, publike ose të tjera është obligim i palës që të njëjtat t'i kompensojë dhe për këto raste të njoftoj KOSTT-in mbi detajet e kompensimit.

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 6 nga 21</i>

## 6. PROCEDURA E DHËNIES SË KUSHTEVE TEKNIKE

1. Secila palë e interesuar për të realizuar ndërtim në afërsi të stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë duhet të drejtohet në KOSTT për të parashtruar kërkesën për dhënien e kushteve teknike duke ndjekur hapat si në procedurën e paraqitur në Shtojcën D.
2. KOSTT obligohet t'i trajtojë kërkesat e palëve duke aplikuar qasje të barabartë, objektive dhe transparente në përputhje me këtë rregullore për të gjitha palët pa përjashtim sipas hapave dhe afateve kohore të paraqitura në këtë shtojcë.

## 7. CENIMI I ZONAVE TË SIGURISË

1. Gjatë aktiviteteve të rregullta të punëtorëve të Sektorit të Mirëmbajtjes së Stabilimenteve Energjetike dhe Sektorit të Sigurisë, Shëndetit dhe Mjedisit, me rastin e vrojtimit të cenimit të zonave të sigurisë apo veprimtarisë së paautorizuar nga pronari apo shfrytëzuesi i tokës, duhet të raportojnë tek Departamenti i Operatorit të Transmisionit (DOT).
2. Sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, kur pronari ose shfrytëzuesi i pronës bëjnë ndërtime të palejuara, rrethime, prerje ose aktivitete të tjera që janë në kundërshtim me rregullat për zonat e sigurisë, KOSTT, përkatësisht DOT, kërkon nga autoriteti kompetent komunal të njoftojë me shkrim pronarin ose shfrytëzuesin e pronës që menjëherë, ta ndalojë ushtrimin e veprimtarisë së paautorizuar, si dhe në rast se pronari apo shfrytëzuesi i tokës që gjendet në zonën e sigurisë, vazhdon ta ushtrojë veprimtarinë e paautorizuar, apo nuk arrin ta mënjanojë ndërtimin e paligjshëm, KOSTT, përkatësisht DOT, kërkon nga autoriteti kompetent komunal që ta evitojë ndërtimin e paligjshëm, apo ta ndalojë atë. Shpenzimet e këtij mënjanimi/rrënimi i bart pronari apo shfrytëzuesi i pronës.

## 8. INFORMIMI I PUBLIKUT

1. Në pajtim me nenin 12 të Udhëzimit Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, KOSTT obligohet që rregullisht të organizojë dhe publikojë programe vetëdijesimi në nivelin komunal përkatës, me qëllim të informimit të publikut, parandalimit të neglizhencës apo abuzimeve mbi tokat e mbrojtura nga regjimi i zonave të sigurisë.
2. Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun rregullisht në bashkëpunim me departamentet e tjera dhe Komisioni Profesional për Dhënien e Kushteve Teknike për Ndërtim në Afërsi të Stabilimenteve Energjetike të Tensionit të Lartë, do të organizojë dhe publikojë programe vetëdijesimi në nivelin komunal përkatës.
3. Kjo rregullore me të gjitha shtojcat e saj do të publikohet në web-faqen e KOSTT: [www.kostt.com](http://www.kostt.com).


## 9. NDRYSHIMI I RREGULLORES

1. Rregullorja do të ndryshohet varësisht nga amandamentimet e ligjeve në të cilat është bazuar ajo.

## 10. HYRJA NË FUQI

2. Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it.



	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 7 nga 21</i>

## 11. BURIMET DHE FORMULARËT

### 11.1. Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1.	Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë
2.	Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët
3.	Ligji Nr. 03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugët Nr. 2003/11
4.	Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës
5.	Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet
6.	Ligji Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet
7.	Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës
8.	Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil
9.	Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura
10.	Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore
11.	Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative
12.	Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë
13.	Kodi i Pajisjeve Elektrike (KOSTT)
14.	Rregullorja mbi Përcaktimin e Zonës nën Servitut për Linjat Transmetuese 110, 220 dhe 400 kV (KOSTT)
15.	Standardi EN 50341: 2012 (Overhead electrical lines exceeding AC 1 kV)
16.	


### 11.2. Dokumentet dhe formularët

Nr.	Emri i dokumentit
1.	Formulari i kërkesës për kushte teknike për ndërtim në afërsi të stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë
2.	Formulari i njoftimit e komunave për cenimin e zonës së sigurisë së stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë
3.	Çmimorja për shërbimet e daljes së komisionit në terren
4.	

## 12. LISTA E SHPËRNDARJES DHE HISTORIKU

### 12.1. Lista e shpërndarjes

Nr.	Emri dhe mbiemri	Data	Nënshkrimi
1.	Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv		
2.	DOT-Departamenti i Operatorit të Transmisionit		
3.	DZHRRP-Departamenti për Zhvillim i Rrjetit dhe Projekte/ Sektori i Ndërtimit të Rrjetit		
4.	DBNJ-Departamenti i Burimeve Njerëzore/Sektori i Sigurisë, Shëndetit dhe Mjedisit		


	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 8 nga 21</i>

5.	Zyra për Cilësi dhe Politika		
6.	Personeli: G:\SMC ISO 9001		
7.			


## 12.2. Shënime për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.0	04.03.2022	Versioni fillestar	5 Vite
2.0			




	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 9 nga 21</i>

### 13. SHTOJCAT

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 10 nga 21</i>

#### **Shtojca A**

Dimensionet e zonave të sigurisë së stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 11 nga 21</i>

1. Zona e sigurisë për linjat transmetuese përcaktohet sipas formulës:

$$ZSLA = SL&DE + PLA + SL&DE.$$

$$ZSLN = SL + PLN + SL.$$

Ku:

ZSLA – Zona e sigurisë së linjës ajrore,

ZSLN – Zona e sigurisë së linjës nëntokësore,

PLA – Profili i linjës ajrore,

PLN – Profili i linjës nëntokësore,

SL&DE – Servituti i linjës dhe distanca elektrike,

SL – Servituti i linjës.

2. Për linjat transmetuese zonat e sigurisë janë:

Niveli i tensionit	Linjat ajrore	Linjat nëntokësore*
110 kV	5 m + PLA + 5 m	1 m + PLN + 1 m
220 kV	6 m + PLA + 6 m	1 m + PLN + 1 m
400 kV	7 m + PLA + 7 m	1 m + PLN + 1 m

\* Zona e sigurisë për linjat transmetuese nëntokësore nuk duhet të jetë më e vogël se:  
4 m.





	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 12 nga 21</i>



Figura 1. Zona e sigurisë për linjat transmetuese ajrore.

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 13 nga 21</i>





Figura 2. Zona e sigurisë për linjat transmetuese nëntokësore.

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 14 nga 21</i>

3. Për nënstacionet zona e sigurisë (ZSN) është:  
2 m nga rrethoja e nënstacionit.






Figura 3. Zona e sigurisë për nënstacionet.



	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 15 nga 21</i>

### Shtojca B

Kushtet teknike për kryëqzim me zonat e sigurisë së stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 16 nga 21</i>

1. Kryqëzimi duhet të bëhet në kënd jo më të vogël se 30 °.
2. Gjatë kryqëzimit me rrugë, distanca minimale vertikale nga toka te përçues më i ulët i linjës transmetuese ajrore duhet të jetë:

Niveli i tensionit	Distanca minimale
110 kV	6.7 m
220 kV	7.75 m
400 kV	9.3 m


3. Gjatë kryqëzimit me rrugë, kanali në sipërfaqen e tokës në të cilin janë shtrirë kabllo e linjës transmetuese nëntoksëore duhet të përfocohet ashtu që të përballojë peshat që do të kalojnë mbi të.
4. Gjatë kryqëzimit me linja të tjera ajrore, distanca minimale vertikale nga cilido përçues i linjës transmetuese ajrore dhe përçuesve të linjave ajrore që operojnë në tensione më të ulëta duhet të jetë:

Niveli i tensionit	Distanca minimale
110 kV	2.8 m
220 kV	3.5 m
400 kV	4.6 m

5. Gjatë kryqëzimit me linja të tjera ajrore, radhitja e kryqëzimit duhet të bëhet sipas nivelit të tensionit. Linja me tensionin më të lartë vendoset përmbi dhe ajo me më të voglin vendost përfundi.
6. Gjatë kryqëzimit me infrastrukturë nëntokësore, nga kabllo e linjës transmetuese nëntoksëore distanca minimale në të gjitha anët duhet të jetë:

Niveli i tensionit	Distanca minimale
110 kV	0.5 m
220 kV	Të përcaktohet sipas rastit.
400 kV	Të përcaktohet sipas rastit.


7. Gjatë kryqëzimit me infrastrukturë nëntoksëore, radhitja e kryqëzimit duhet të bëhet sipas nivelit të tensionit. Linja transmetuese nëntokësore vendoset në pjesën më të poshtme të kanalit dhe përmbi saj vendosen linjat e tjera nëntoksëore që operojnë në në tensione më të ulëta, si dhe gypat e ndryshëm.

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 17 nga 21</i>

### Shtojca C

Distancat minimale të sigurisë sipas ligjeve për ndërtimet në afërsi të stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë




	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 18 nga 21</i>

1. Distanca minimale e sigurisë mes stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë dhe ndërtimeve të tjera sipas ligjeve në fuqi për rastet e mëposhtme:

Lloji i ndërtimit	Distanca minimale
Rrugët lokale	10 m
Rrugët regjionale	10 m
Rrugët magjistrale	20 m
Autoudhët	40 m
Hekurudhat	25 m
Minierat	150 m
Lumenjt	30 m
Liqenet	30 m

2. Distanca minimale e sigurisë mes stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë dhe rezervuarëve, pompave dhe çfarëdo infrastrukture tjetër për ruajtjen dhe bartjen e produkteve të naftës dhe gazit natyror duhet të jetë:  
Lartësia e shtyllës + 3 m.
3. Distanca minimale e sigurisë mes stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë dhe aeroporteve/aerodromeve përcaktohet me kërkesë sipas rastit.
4. Brenda zonave të veçanta të mbrojtura është i ndaluar ndërtimi i stabilimeve energjetike të tensionit të lartë. Distanca minimale e sigurisë mes stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë dhe zonave të veçanta të mbrojtura është e përcaktuar sipas listës së monumenteve.

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 19 nga 21</i>

#### **Shtojca D**

Procedura e dhënies së kushteve teknike për ndërtim në afërsi të stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë



**RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI  
TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË  
TENSIONIT TË LARTË**


**PO-KSHE-001**

*ver. 1.0*

*Faqe 20 nga 21*

Hapi	Veprimet e nevojshme	Afatet kohore
1	<p>Pala e dorëzon kërkesën me shkrim në Arkivën Qendror të KOSTT.</p> <p>Formulari i kërkesës mund të tërhiqet në Arkivën Qendror të KOSTT ose mund të shkarkohet nga web-faqja e KOSTT: <a href="http://www.kostt.com">www.kostt.com</a>.</p> <p>Formulari i kërkesës duhet të përmbajë këto shënime nga personi fizik apo personi juridik:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Emrin dhe mbiemrin,</li><li>▪ Adresën e plotë,</li><li>▪ Email adresën,</li><li>▪ Numrin e telefonit,</li><li>▪ Informatën për qëllimin e kërkesës për ndërtim në afërsi të stabilimenteve energjetike të tensionit të lartë.</li></ul> <p>Formularit të kërkesës duhet t'i bashkangjiten këto dokumente:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Kopja e dokumentit të identitetit.</li><li>▪ Fleta poseduese e parcelës dhe kopja e planit të parcelës në emrin e palës ose autorizimi përkatës i noterizuar jo më i vjetër se 6 muaj.</li><li>▪ Kopja e planit ideor të objektit që planifikohet të ndërtohet.</li><li>▪ Matja gjeodezike e distancave për raste të veçanta.</li><li>▪ Nëse pala është person juridik, atëherë duhet të dorëzohen shtesë dokumentet e kompanisë (Informata e Biznesit dhe Certifikata e Regjistrimit) me autorizimin përkatës.</li></ul>	N/A.
2	<p>Pas dorëzimit të kërkesës së plotë në Arkivën Qendror të KOSTT, nga Komisioni Profesional për Dhënien e Kushteve Teknike për Ndërtim në Afërsi të Stabilimenteve Energjetike të Tensionit të Lartë përgatitet fatura për dalje të këtij komisioni në terren sipas çmimores së përcaktuar nga KOSTT. Çmimorja në fjalë mund të shkarkohet në web-faqen e KOSTT: <a href="http://www.kostt.com">www.kostt.com</a></p> <p>Fatura për pagesë i dorëzohet palës nga komisioni në fjalë.</p>	

**Parashtrimi i kërkesës me pagesë nga pala nuk nënkupton njëkohësisht edhe miratimin e kushteve teknike nga KOSTT. Në rastin e refuzimit të kushteve teknike nga KOSTT palës nuk i kthehen mjetet e deponuara për kërkesën.**

	<b>RREGULLORE PËR NDËRTIMET NË AFËRSI TË STABILIMENTEVE ENERGJETIKE TË TENSIONIT TË LARTË</b>	<b>PO-KSHE-001</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 21 nga 21</i>

3	<p>Arkiva Qendrore e KOSTT kërkesën e dorëzuar nga pala e evidenton në ditarin e protokollimit që mbahet në KOSTT. Kërkesa e protokolluar dorëzohet te Komisioni Profesional dhe Drejtori i DOT përmes emailit.</p>	
4	<p>Komisioni Profesional në bashkëpunim me parashtruesin e kërkesës, pas pranimit të dokumentacionit të kompletuar dhe dëshmisë së pagesës realizon daljen në terren dhe përgatit raportin me përgjigjen. Në rast kur distancat e sigurisë nuk mund të konstatohen me vrojtim të lirë, Komisioni Profesional i kërkon me email palës matje gjeodezike.</p> <p>Raporti i përgatitur dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit Profesional i dorëzohet Drejtorit të DOT i cili bashkëngjit fletën përcjellëse të nënshkruar.</p> <p>Përgjigja e protokolluar i dorëzohet palës nga Arkiva Qendrore.</p>	<p>Dorëzimi i përgjigjes nga Arkiva Qendrore duhet të bëhet jo më larg se 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës.</p>
5	<p>Pala pas pranimit të përgjigjes nëse është e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë me shkrim në Arkivën Qendrore të KOSTT. Ankesa nga Arkiva Qendrore dorëzohet te Zyra e KSHE për trajtim të mëtejshëm.</p>	<p>Afati i ankesës është 30 ditë kalendarike pas pranimit të përgjigjes, ose protokollimit në ditarin e protokollimit të Arkivës Qendrore të KOSTT.</p>
6	<p>Zyra e KSHE përcakton një Komision për Shqyrtimin e Ankesës.</p> <p>Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës njoftohet me vendimin e KSHE dhe anëtarët e komisionit duhet të jenë persona kompetent dhe jo nga Komisionit Profesional për Dhënie të Kushteve Teknike për Ndërtim në Afërsi të Stabilimenteve Energjetike të Tensionit të Lartë.</p> <p>Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave raportin e përgatitur, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e dorëzon nëpërmjet Arkivës Qendrore te Zyra e KSHE. Pas dërgimit të raportit të komisionit te Zyra e KSHE, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave e njofton KSHE me përgjigjen e përgatitur bazuar në konstatimet në raport, e njëjta nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe dorëzohet në Arkivën Qendrore për protokollim dhe pastaj përcjellët tek pala.</p> <p>Arkiva Qendrore nëpërmjet komunikimit zyrtar e njofton palën që ta tërheq dokumentin duke nënshkruar në ditarin e protokolluar.</p>	<p>Dorëzimi i përgjigjes së ankesës nga Arkiva Qendrore duhet të bëhet jo më larg se 30 ditë kalendarike nga data e pranimit të saj.</p>